

UDHËZIM
Nr. 21, datë 26.10.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3743, DATË
10.7.2017, “MBI MODELET DHE STANDARDET E BILETAVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR TË UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 21/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të pikës 4, të kreut I dhe pikës 3 të kreut III, të vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“Fusha e zbatimit të këtij udhëzimi është përcaktimi i modeleve dhe i standardeve të biletave (me çmim të parashtypur, letër dhe elektronike), si dhe përdorimi i tyre në transportin rrugor të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar)”.

2. Në pikën 3, shkronja “c”, hiqet termi “ndërqytetës” dhe shtohen përkufizimet me përmbajtje, si më poshtë:

“dh) “Biletë në format letër” është biletë për një udhëtim në shërbimin e transportit ndërqytetës të udhëtarëve me autobus, e gjeneruar nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport*, me vulë elektronike, e cila shërben si dokument tatimor në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.”.

“gj) “Sistemi elektronik *e-Transport*” është sistem i dedikuar për prerjen e biletave në transportin ndërqytetës, i cili garanton ciklin e plotë fiskal të biletës dhe kryen monitorimin e subjekteve të transportit ndërqytetës nëpërmjet pajisjeve të transaksionit elektronik të biletimit.”.

“11) “Agjencia e transportit të udhëtarëve (brenda vendit dhe/ose ndërkombëtar)”, është person fizik ose juridik, e licencuar sipas legjislacionit në fuqi, e cila përdor sistemin elektronik *e-Transport* për ndjekjen e ciklit të plotë të pajisjes me bileta (emetimit/shitjes së biletave), përzgjedhjen e linjës së transportit ndërqytetës, caktimin e vendeve/ulëseve në mjet/autobus, të orareve, të fiskalizimit, menaxhimin elektronik në kohë reale të biletave të prera dhe kryen shitjen e biletave për llogari të shoqërisë së transportit, në bazë të kontratës së lidhur midis palëve (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), subjekteve transportuese të pajisura me licencë për shërbimin në linjat e transportit ndërqytetës dhe/ose agjencive të transportit të udhëtarëve)”.

“nj) “Pajisje e transaksionit elektronik të biletimit”, janë pajisje të instaluar në mjetet e transportit rrugor ose kudo tjetër, të integruara me sistemin *e-Transport*, të cilat plotësojnë kërkesat e ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar dhe garantojnë ciklin e plotë fiskal të biletës.”.

“sh) “Pagesë *online*” është pagesa e kryer kundrejt operatorëve të transportit për blerjen e biletës së udhëtimit në format letër, nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport* dhe platformës qeveritare të ndërveprimit për pagesën elektronike, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)”.

3. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshon si më poshtë:

“Bileta tatimore me çmim të parashtypur për një udhëtim në transportin qytetës, rrethqytetës dhe transportin ndërkombëtar rrugor përmban në krye të saj të shënuar: Republika e Shqipërisë;

ministrja përgjegjëse për financat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në mes shënohet lloji i biletës (qytetës/rrethqytetës dhe/ose transport ndërkombëtar rrugor). Më poshtë shënohet çmimi i udhëtimit. Në fund, në cepin e djathtë, shënohet “Kodi i prodhimit” dhe “nr. serial”. Në krahun e majtë vertikalisht shënohen për efekt kontrolli përkatësisht “nr. serial” dhe “Kodi i prodhimit”.

4. Shtohet pika 4.1, me përmbajtje, si më poshtë:

“4.1 Bileta në format letër, e gjeneruar nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport* për një udhëtim në transportin rrugor ndërqytetës, përmban në krye të saj të shënuar: Ministria përgjegjëse për transportin rrugor, ministrja përgjegjëse për financat, autoriteti kompetent i licencimit. Në mes shënohet linja, gjatësia e udhëtimit, data e nisjes, ora e nisjes, vendi, etiketa e bagazhit. Në fund shënohet operatori, targa e mjetit, nr. telefoni, NUIS, vendi i nisjes, vendi i mbërritjes, numri i serisë, çmimi. Bileta në format letër përmban elementet e fiskalizimit dhe vulën elektronike. Format i biletës letër në transportin ndërqytetës është sipas modelit të miratuar me këtë udhëzim. Çmimet e biletave të transportit ndërqytetës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Sistemi elektronik *e-Transport* krijon kushtet e nevojshme për shitjen e biletave për personat që përfitojnë lehtësira në çmim me ligje të veçanta.

Biletat në format letër gjenerohen nëpërmjet sistemit elektronik *e-Transport*, nga agjencitë e transportit të udhëtarëve, pajisjeve të transaksionit elektronik, *online* në *web* ose aplikacioneve mobile nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit për pagesën elektronike, zhvilluar nga AKSHI. Sistemi elektronik *e-Transport* plotëson kërkesat e ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, krijon ndërlidhje në kohë reale me sistemet e treta që mundësohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit dhe në të gjitha rastet duhet të sigurojë ciklin e plotë fiskal të biletës. Pajisja e transaksionit elektronik të biletës, e instaluar në mjetet e transportit ndërqytetës ose kudo tjetër, e pajisur me GPS, për efekt monitorimi, jepet në përdorim nga DPSHTRR-ja, sipas kushteve dhe tarifave të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur midis palëve, (DPSHTRR, subjekteve/operatorëve transportuese të pajisur me licencë për shërbimin në linjat e transportit ndërqytetës, dhe/ose agjencive të transportit të udhëtarëve)”.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

6. Pika 4 e këtij udhëzimi, i shtrin efektet në përputhje me vendimin nr. 224, datë 13.4.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku